



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar

Tiranë, më 17.09.2019

RAPORT

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9695, DATË 19.3.2007, “PËR PROCEDURAT E BIRËSIMIT DHE KOMITETIN SHQIPTAR TË BIRËSIMIT”, TË NDRYSHUAR”

- Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 17.09.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr. 9695, datë 19.3.2007, “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, të ndryshuar”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relatore për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten znj. Vasilika Hysi.

Në mbledhjen e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit, ishin të pranishëm znj. Fjoralba Caka, zëvendësministre e Drejtësisë dhe z. Besmir Beja, Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit dhe i Harmonizimit të Legjislacionit.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit. Meqënëse ndryshimet e Rregullores së Kuvendit lidhur me kërkesat që duhet të përmbushë relacioni që shoqëron projektligjin, kanë hyrë në fuqi pas depozitimit të projektligjit në Kuvend, rregullat e reja të nenit 68 të Rregullores nuk zbatohen për këtë projektligj.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Ndryshimi i propozuar në ligjin nr. 9695, datë 19.3.2007, “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, ka për qëllim zgjerimin e fushës së formimit të aplikantëve për pozicionin e kryetarit të Komitetit Shqiptar të Birësimit (*në vijim Komiteti*), duke krijuar mundësinë për përzgjedhjen e kandidatëve më të përshtatshëm dhe më shumë mundësi përzgjedhjeje të kandidatëve më të mirë.

Ligji në fuqi përcakton se një nga kriteret e përzgjedhjes së kryetarit të Komitetit, është që kandidati të ketë përfunduar arsimin e lartë në shkencat juridike, niveli minimal i diplomës “Master shkencor”.

Në vlerësimin e Ministrisë së Drejtësisë, kriteri i përzgjedhjes së kryetarit të këtij Komiteti nuk mund të kufizohet vetëm me përfundimin e studimeve në shkencat juridike, pasi procedura e birësimit udhëhiqet nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës, vlerësim i cili, në një rast konkret, nuk mund të bëhet vetëm nga një jurist.

Sipas relacionit që shoqëron projektligjin dhe prezantimit të bërë në komision nga përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, u theksua se një vlerësim i tillë mund të bëhet edhe nga psikologët, punonjësit socialë ose edhe persona nga fusha të tjera të shkencave sociale. Janë këta persona që thirren nga gjykatat për dhënien e një mendimi të kualifikuar mbi gjendjen e fëmijës dhe të prindërve, raportet midis tyre, etj. në procedurat gjyqësore, në të cilat preken të drejtat e fëmijëve.

Gjithashtu, argumenti tjetër i sjellë në relacion si dhe gjatë diskutimit në Komision nga përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, se pranë Komitetit janë të punësuar mjaftueshëm juristë, e bën të panevojshëm kufizimin e kriterëve të përzgjedhjes së kryetarit të Komitetit.

III. ÇËSHTJE TË DISKUTUARA NË KOMISION

Zëvendësministrja e Drejtësisë, znj. Caka, pasi bëri një prezantim përpara anëtarëve të komisionit lidhur me ndryshimet që propozohen në ligjin në fuqi, parashtoi disa nga argumentet që lidhen me nevojën për miratimin e këtyre ndryshimeve.

Së pari, zgjerimi i fushës së arsimit në shkencat humane, shkencat juridike ose shkencat sociale, si kriter për emërimin e drejtorit të Komitetit Shqiptar të Birësimeve, do t’u krijonte mundësinë e kandidimit edhe personave të cilët kanë eksperiencë në fushën e birësimeve si: punonjësve socialë, psikologëve etj., të cilët duke njohur mirë anën psikologjike dhe marrëdhëniet ndërpersonale prind-fëmijë do të jenë një kontribut dhe vlerë e shtuar për institucionin.

Së dyti, një tregues tjetër që nxiti Ministrinë e Drejtësisë në propozimin e zgjerimit të fushës së arsimit, si kriter për emërimin e drejtorit të Komitetit, është se aplikimet e paraqitura deri tani, nuk janë ato më të mirat dhe nuk plotësojnë të gjitha kriteret e standartet e përcaktuara në ligj. Analiza jo vetëm e gjendjes aktuale në vend, por edhe i modeleve më të

mira të institucioneve homologe në vende të tjera, theksoi domosdoshmërinë e ndryshimit të këtij kufizimi ligjor.

Në vlerësimin e Ministrisë së Drejtësisë, mundësia e kandidimit të aplikantëve që kanë përfunduar arsimin e lartë, jo vetëm në shkencat juridike, por edhe në shkencat humane dhe ato sociale, do të përmirësonte dhe do të shtonte ndjeshmërinë në raportet njerëzore, duke pasur në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës.

Në përgjigje të pyetjeve të relatores znj Hysi dhe deputetëve në Komision, lidhur me problematikat e hasura në praktikë nga miratimi i ndryshimeve të bëra në këtë ligj në vitin 2015 dhe deri më sot, zëvendësministria znj. Caka iu referua dispozitave të Konventës së Hagës mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit, e konkretisht nenit 11, pika b, ku përcaktohet se organi i akredituar për birësimet *“drejtohet dhe ka një personel me persona të kualifikuar në normat e sjelljes dhe që kanë kualifikim ose përvojë për të punuar në fushën e birësimit jashtë vendit”*. Përcaktimet e bëra në këtë dispozitë theksojnë rëndësinë e kualifikimeve dhe përvojës së drejtuesit në fushën e birësimeve dhe nuk kufizohet në formimin shkollor akademik të tij.

Neni 15 i Konventës së Hagës parashikon se në rast se përmbushen kërkesat që aplikuesit kanë të drejtë dhe janë të përshtatshëm për të birësuar, Autoriteti Qendror i Shtetit pritës përgatit një raport, i cili përfshin informacion *mbi identitetin e aplikantëve, të drejtën dhe përshtatshmërinë për të birësuar, biografinë e tyre, familjen dhe gjëndjen shëndetësore, mjedisin shoqëror, arsyet për birësim, mundësinë për të ndërmarrë një birësim jashtë vendit, si dhe karakteristikat e fëmijëve, për të cilët ata do të zgjidhen të kujdesen*.

Në nenin 22 të kësaj Konvente përcaktohen si kritere për autoritetet kompetente në fushën e birësimit:

- a) *të plotësojnë kërkesat e integritetit, kompetencat profesionale, përvojës dhe përgjegjshmërinë të atij Shteti, dhe*
- b) *janë të kualifikuar për normat e tyre morale dhe për kualifikimin ose përvojën në punë në fushën e birësimit jashtë vendit.*

Konventa, në tërësinë e dispozitave të saj, thekson rëndësinë e përvojës dhe ekspertizës në fushën e birësimit dhe jo vetëm formimin akademik.

Në frymën e dispozitave të Konventës së Hagës, Ministria e Drejtësisë, me propozimet e paraqitura për ndryshim në ligjin në fuqi, synon të tërheqë jo vetëm kandidatët që kanë një diplomë në fushën e drejtësisë, por edhe kandidatët që për shkak të profesionit të tyre si psikologë, punonjës socialë, gazetarë etj., kanë përvojë të konsiderueshme në fushën e birësimeve.

Në përmbyllje të diskutimeve të anëtarëve të komisionit, relatorja theksoi nevojën e një reforme të thellë në fushën e birësimit dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, duke kërkuar angazhimin e Ministrisë së Drejtësisë për ndryshimet e nevojshme në Kodin e Familjes lidhur me kujdestarinë, procedurat e birësimit etj., duke u bazuar në rekomandimet e organizatave vendase dhe ndërkombëtare që kanë në fokusin e veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve si dhe në përputhje me konventat ndërkombëtare të aderuara nga vendi ynë.

Nevoja për përditësim të legjislacionit në fushën e familjes diktohet edhe nga fakti se prej miratimit të Kodit të Familjes dhe deri më sot, Shqipëria ka ratifikuar shumë konventa në

mbrojtje të të drejtave të fëmijëve dhe praktika e përditshme ka nxjerrë në pah problematika që nuk adresohen në respekt të parimit “të interesit më të lartë të fëmijës” dhe që bëjnë të domosdoshme përmirësimet në Kodin e Familjes.

IV. PËRFUNDIME

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

- a) *Në aspektin ligjor*, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- b) *Në aspektin procedural*, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e shumicës së anëtarëve të komisionit e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATORE

KRYETARI

VASILIKA HYSI

ULSI MANJA